



In medias res

## **Planifikimi, Thembër e Akilit e ndryshimeve në arsimin e Kosovës (2)**

*(vazhdim nga Letra Informative shkurt 2010)*

Sipas Barunit dhe Ajzenhardit (1998) në praktikën e qeverisjes në situatat e cepit të kaosit bëjnë pjesë këto nevoja :

- Kultivohet kultura e ndryshimeve të shpeshta në kontekstin e numrit të vogël të rregullave rigoroze
- Shumica e aktiviteteve mbahen në një strukturë tejet labile që kanë pikëmbështetëse në struktura thelbësore të prioritete, masave të synuara, afateve reale dhe të përgjegjësive për rezultat më të rëndësishme
- Brenda grupeve dhe ndërmjet grupeve vendosen kanale të komunikimit në kohën reale objekt i të cilave janë rezultate reale”.

Nëse procesin e planifikimit të deritashëm në Kosovë e analizojmë në dritën e këtyre konstatimeve shkencore, atëherë mund të konstatojmë se planifikimi thënë qartë ka qenë i gabuar sepse nuk është bërë mbi kërkesat e Teorisë së ndryshimeve, andaj dhe është bërë faktorë i dështimeve duke krijuar struktura tepër të forta dhe të ngurta (nëpërmjet dhjetëra strategjive) në një anë, dhe duke mos kultivuar kulturë të ndryshimeve të shpeshta, të strukturave labile të bazuara në prioritet thelbësor, afate reale, përgjegjësi për rezultate më të rëndësishme si dhe duke mos vendosur kanale komunikimi brenda kohës reale qoftë brenda grupit, ashtu edhe ndërmjet e grupeve (qasja ndër-sektoriale, që tani është duke ndodhur) objekt i të cilave janë rezultatet reale dhe të vlefshme .

Në planifikimet tona tani më shumë duhet të përqendrohemi që të sfidojmë gjerat e paparashikueshme, kontra-kultura që janë në konflikt, mungesën e konsensusit (p.sh ndërmjet shumicës shqiptare dhe bashkësisë serbe - HH), në konflikte, mospajtime, në jo-qëndrueshmërinë, si dhe të përdoren në dobi të vetë.

*Shkroi: Halim Hyseni*

## **Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH**

■ Më 13-14 mars është mbajtur seminari i katërt me titull "Teknika për zhvillimin e mendimit kritik" për 120 mësime të Prishtinës, Ferizajit, Gjilanit dhe Pejës të cilat janë duke vijuar programin e MKLSH-së. Trajnerët kanë raportuar se mësime të shumë aktiv në realizimin e detyrave të parapara me programin e trajnimit. Në fund pjesëmarrësit janë njoftuar se seminari i pestë do të mbahet më 10-11 prill 2010.

## **Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës**

■ Në kuadër të programit "Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës", gjatë muajit mars 15 monitorët e komunave të Prishtinës, Vushtrisë, Gjakovës, Istogut dhe Gjilanit kanë realizuar intervistat me drejtorë të shkollave të tyre si dhe zyrtarë financiar të DKA-ve përkatëse. Rezultatet e intervistave do të përmbledhen në një raport të përbashkët.

## **Hap pas Hapi**

■ Në kuadër të programit Hap pas Hapi, në Pejë u organizua trajnimi i grupit të tretë për klasën e dytë me këto data 28 shkurt, 6 dhe 13 mars. Prezantimet e planifikimeve javore për të tre grupet e klasave të treta që u organizuan gjatë këtyre dy muajve në Pejë u mbajtën me këto data:

Grupi I me 20.03.2010  
Grupi II me 21.03.2010  
Grupi III me 27.03.2010

■ Me datat 6, 7 dhe 13 mars në Prizren u mbajt trajnimi për klasën e tretë, ndërsa prezantimi i planifikimeve javore u realizua me datën 27 mars.

■ Në Prishtinë me datat 19, 20 dhe 21 mars u organizua trajnimi për klasën e dytë. Ky grup prezantimet e planifikimeve mujore do të mbaj me datën 11 maj, gjë që është kusht për certifikim.

## **KOSOVISION Contest**

■ Këtë muaj, të gjitha shkollat respektivisht klasat fituese të projektit kanë filluar punën e tyre në realizimin e projektit. Të gjithë janë pajisur me mjete të cilat iu nevojiten për punë. Disa nga shkollat janë afër përfundimit të projektit. Nxënësit janë duke punuar me shumë entuziazëm.

■ Përfaqësuesit nga Zvicra pra udhëheqësit e projektit kanë qenë në vizitë gjatë muajit mars dhe kanë bërë vizita në shumë shkolla për të parë nëse mësuesit kanë vështirësi gjatë realizimit të projekteve. Fotot më poshtë tregojnë se me sa entuziazëm dhe sa kanë kreativitet nxënësit në punën me projekt.





### **Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit**

■ Në kuadër të këtij projekti “Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit”, financuar nga Komisioni Evropian, janë organizuar aktivitetet sipas projektit.

Të gjitha trajnimet e parapara sipas planit vjetor janë mbajtur gjatë muajit mars. Pesë grupe trajnimi kanë përfunduar nga dy ditë trajnim për të drejtat e fëmijës dhe nga një ditë për avokim. Grupi i gjashtë me nxënësit e komunitetit boshnjak është paraparë të mbahet në fillim të muajit prill.

■ Edhe cikli i dytë i monitorimit ka filluar. Të gjithë pyetësorët janë shpërndarë në shkolla dhe ka filluar edhe

plotësimi i tyre. Tani monitoruesit e jashtëm kanë filluar edhe mbledhje e pyetësorëve për të filluar më pas me futjen e të dhënave për monitorimin e dytë



### **Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim**

■ Raporti “Hulumtimet Kombëtare” në kuadër të komponentës 2 të Projektit është përfunduar dhe është përkthyer në gjuhën angleze. Edhe hulumtuesit nga Shqipëria, Kroacia dhe Serbia i kanë përfunduar “Hulumtimet Kombëtare” në shtetet e tyre. Ka mbetur vetëm edhe hulumtuesi nga Bosnia dhe Hercegovina ta përfundojë raportin e vet.

■ Sa i përket komponentës 3 të projektit “Praktikat më të mira” gjatë muajit mars është pranuar edhe një aplikim për praktikë të mirë dhe janë kontaktuar edhe disa mësimdhënës për disa aplikime të reja.

### **Access Microscholarship Program**

■ Dy grupet e Access në Prishtinë janë shkrirë në një grup për shkak të interesimit të vogël të nxënësve nga komuniteti serb për vijim të rregullt të mësimet. Përndryshe

---

orët janë mbajtur me rregull dhe janë bërë përgatitje për javën ndërkombëtare të bibliotekës që do të mbahet në prill.

### **Koncepti i qytetarisë të nxënësit e shkollës fillore në Kosovë**

■ Gjatë muajit mars është mbajtur një takim në mes të përfaqësuesve të KEC dhe atyre nga Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës. Qëllimi i takimit gjithëditor ishte përpilimi i dokumentacionet përkatës që është kërkuar nga partneret zviceran për të aplikuar për projektin e ri. Ky dokumentacion është kompletuar dhe përkthyer, dhe është dërguar. Partnerët nga PHZH e kanë kompletuar dokumentacionin dhe e kanë dërguar. Gjatë muaji maj presim ndonjë përgjigje për mundësinë e vazhimit të projektit.

### **Projekti i përbashkët i historisë së Evropës Juglindore (JHP)**

■ Në kuadër të këtij projekti, gjatë muajit mars, kanë vazhduar përgatitjet për trajnimet që do të mbahet në Pejë dhe Gjilan.

*Përgatiti: Petrit Tahiri*